



ILLYRIAN GUARD SHA

Nr. 1611 Prot.

Tiranë, më 20.10.2021

Lënda: Njoftim në lidhje me ofrimin e shërbimit të ruajtjes, shoqërimit dhe transportimit të vlerave monetare nga Shoqëria "Illyrian Guard" ShA

OPERATORIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE

TIRANË

Shoqëria "Illyrian Guard" ShA është krijuar me VKM nr.177, datë 04.04.2019 "Për krijimin e Shoqërisë "Illyrian Guard", Sh.A., dhe për përcaktimin e autoritetit publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të kësaj shoqërie" për të ofruar shërbime me pagesë, kundrejt subjekteve të treta, publike apo private, në fushën e rendit e të sigurisë publike, teknologjisë së informacionit, si dhe çdo shërbim tjetër në përputhje me qëllimin e krijimit dhe statutin e saj.

Duke marrë parasysh që drejtori rajonale të OSSH sha dhe FSHU sha, pjesë e OSHEE Group, i janë drejtuar me kërkesë Shoqërisë "Illyrian Guard" ShA për përfitimin e shërbimit të të ruajtjes, shoqërimit dhe transportimit të vlerave monetare, ju bëjmë me dije se:

Megjithëse Shoqëria "Illyrian Guard" ShA ka realizuar liçencimin për shërbimin në nënkategorinë 1.3.B "Sigurimi dhe shoqërimi i vlerave monetare, materiale dhe sendeve të çmuara gjatë transportit", ende ky shërbim nuk është në efikasitet të plotë.

Referuar më sipër, ju bëjmë me dije se Shoqëria "Illyrian Guard" ShA, nuk mund të ofrojë shërbimin e nënkategorisë 1.3.B deri në momentin që pritet të plotësohen kushtet e sipërpërmendura. Gjithashtu, shoqëria jonë merr përsipër t'ju njoftojë në kohën kur do të jetë e gatishme të ofrojë këtë shërbim gjatë vitit 2022.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

ADMINISTRATORIA E SHOQËRISË
"ILLYRIAN GUARD" SH.A.
ROBERT L. [Signature]
MINISTRIA E BRENDSHME
TIRANË